

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
DREJTORIA E TARIFAVE DHE ÇMIMEVE****RELACION****MBI ÇMIMIN E SHITJES ME PAKICË PËR KLIENTËT E SHËRBIMIT UNIVERSAL PËR
PERIUDHËN 1 SHKURT 2025 - 31 DHJETOR 2025****Tiranë**

Të nderuar anëtarë të Bordit,

Në mbështetje të nenit 83 dhe nenit 85 të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, Enti Rregullator i Energjisë është autoriteti përgjegjës për përcaktimin e çmimeve të rregulluara për klientët fundorë që furnizohen sipas shërbimit universal të furnizimit.

Konform legjislacionit në fuqi, ERE kreu një vlerësimi mbi mjaftueshmërinë e të ardhurave të aktivitetit të shërbimit universal të furnizimit, i cili u bazua mbi të dhënat e vëna në dispozicion nga FSHU sh.a. Në vijim, bordi i ERE me anë të vendimit nr. 298, datë 30.12.2024, bazuar në konstatimet dhe rrethanat e cilësuar në këtë vendim, me qëllim që shoqëria të vijonte faturimin bazuar në çmimet e miratuara nga ERE, vendosi:

1. Të zgjatet fuqia juridike e vendimit të bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.04.2022, deri më 31.01.2025, për çmimet me pakicë të energjisë elektrike për klientët fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal.
2. Të zgjatet fuqia juridike e vendimit nr. 72, datë 15.04.2024, deri më 31.01.2025, për çmimet e shitjes së energjisë elektrike për klientët e kategorisë “Furra buke/prodhim mielli” të lidhur në nivelin e tensionit 0.4 kV.

FSHU sh.a. me korrespondencën nr. 6670/2 prot., datë 31.12.2024 (protokolluar me tonën me nr. 2654 prot., datë 31.12.2024), depozitoi në ERE “Kërkesën për rivlerësim të kostove që përcaktojnë Çmimin me Pakicë për Klientët e Shërbimit Universal nga 1 Shkurt 2025”. Me anë të kësaj kërkesë, ndër të tjera shoqëria bën me dije se:

“FSHU sh.a. është njoftuar gjithashtu se çmimi i furnizimit nga KESH sh.a. për klientët që furnizohen në kushtet e shërbimit universal për vitin 2025 do të ulet në 2.34 Lekë/kwh nga 2.6 Lekë/Kwh.

Në kushtet e përmirësimit të ndjeshëm të situatës financiare të shoqërisë si edhe të perspektivës së zhvillimeve për vitin 2025, kërkojmë rivlerësim të kostove që përcaktojnë çmimin për Klientët e Shërbimit Universal që furnizohen në nivelin e tensionit të ulët 0.4 kv.”

Bashkëlidhur kësaj kërkesë shoqëria ka paraqitur vlerësimin e saj në lidhje me kostot e përcaktimit të çmimeve të shitjes me pakicë për klientët e Shërbimit Universal. Në këtë vlerësim, përfshihen të dhënat mbi treguesit si më poshtë:

- Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve paraprake të periudhës ushtrimore 2023, pritshmëritë e saj për mbylljen e vitit 2024;
- Parashikimin në lidhje me zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2025;
- Sasinë totale të energjisë elektrike të furnizuar në periudhën 2023 si dhe parashikimin e saj për vitin 2024;
- Sasinë totale të energjisë që pret të tregtojë për periudhën 2025 duke evidentuar për secilën kategori konsumtatori i cili do të shërbehet nga FSHU sh.a. si dhe nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

Në vijim paraqesim tabelën mbi treguesit kryesorë të performancës për 2024 (i pritshëm) krahasuar me vitin 2023:

| 000/Lekë | Përshkrimi | 2023 | Parashikim 2024 | Diferenca (2024-2023) | % |
|---------------------------------|-----------------------------------|-------------------|-------------------|-----------------------|----------------|
| Të Ardhurat | Të ardhura nga Shitja e energjisë | 67,803,524 | 63,579,166 | ↓ (4,224,358) | 93.8% |
| | Të ardhura nga kamatëvonesat | 1,337,838 | 1,003,989 | ↓ (333,849) | 75.0% |
| | Të tjera | 156,377 | 448,831 | ↑ 292,454 | 287.0% |
| | Gjithsej | 69,297,739 | 65,031,986 | ↓ (4,265,753) | 93.8% |
| Shpenzimet | Shpenzime Energji dhe tranmetim | 24,876,865 | 18,800,811 | ↑ (6,076,054) | 75.6% |
| | Shpenzime Operative | 2,521,463 | 3,276,537 | ↓ 755,074 | 129.9% |
| | Provizione | 2,033,237 | 1,272,257 | ↑ (760,980) | 62.6% |
| | EBITDA | 328,788 | 1,826,585 | ↑ 1,497,797 | 555.6% |
| | Amortizimi | 125,950 | 183,097 | ↓ 57,147 | 145.4% |
| | Shpenzime Financiare | 123,085 | 234,790 | ↓ 111,704 | 190.8% |
| | Tatim Fitimi | 50,121 | 379,368 | ↓ 329,247 | 756.9% |
| | Gjithsej | 69,268,107 | 64,002,655 | ↑ (5,265,452) | 92.4% |
| REZULTATI I AKTIVITETEIT | | 29,632 | 1,029,331 | ↑ 999,699 | 3473.7% |
| Energji e Shitur (Mwh) | | 5,571,990 | 5,491,194 | ↓ (80,796) | 98.5% |
| Arkëtim | | 97.89% | 98.00% | | |

Burimi. FSHU sh.a.

FSHU sh.a. deklaron se vlerësimet paraprake për vitin 2025 janë mbështetur në supozimet e evidentuara në vijim:

- Të gjithë klientët në tensionin 10 kv me një konsum vjetor prej rreth 150 Gwh (me përjashtim të shoqërive të ujësjellësve) do të furnizohen në tregun e lirë.
- Sasia e energjisë së shitur për klientët e FSHU për vitin 2025 është parashikuar të jetë rreth 0.7% më e lartë se ajo e pritshme e vitit 2024 me rreth 4,899 Gwh për klientët që furnizohen nga Shërbimi Universal dhe 444 Gwh për klientët që furnizohen në kushtet e Furnizimit të Mundësisë së Fundit, për një total prej rreth 5,343 Gwh.
- Të gjithë klientët e Shërbimit Universal (në tensionin 0.4 kv) do të furnizohen nga KESH me çmimin 2.34 Lekë/kwh.
- Klientët në kushtet e Furnizimit të Mundësisë së Fundit do të furnizohen nga KESH me çmimin 12 Lekë/kwh.
- FSHU do të ulë çmimin mesatar të shitjes për klientët e Shërbimit Universal nga rreth 10.83 Lekë/Kwh që rezuton aktualisht në 10.23 Lekë/Kwh.

- Objektivi i normës së arkëtimit për vitin 2025 do të jetë 99%, i cili është 1% më i lartë se objektivi i vitit 2024 dhe 5% më i lartë se ai i vendosur në Planin e Rimëkëmbjes Financiare të Sektorit Elektroenergjitik vendosur nga Qeveria Shqiptare.

FSHU sh.a. ka kryer parashikimin në lidhje me treguesit ekonomik, të cilët paraqiten në tabelën si më poshtë:

| 000/Lekë | Përshkrimi | Parashikim 2024 | Plan 2025 | Diferenca (2024-2023) | % |
|---------------------------------|-----------------------------------|-------------------|-------------------|-----------------------|--------------|
| Të Ardhurat | Të ardhura nga Shitja e energjisë | 63,579,166 | 58,506,892 | ↓ (5,072,275) | 92.0% |
| | Të ardhura nga kamatëvonesat | 1,003,989 | 1,020,941 | ↑ 16,952 | 101.7% |
| | Të tjera | 448,831 | 448,831 | ↑ - | 100.0% |
| | Gjithsej | 65,031,986 | 59,976,664 | ↓ (5,055,322) | 92.2% |
| Shpenzimet | Shpenzime Energji dhe tranmetim | 18,800,811 | 15,737,761 | ↑ (3,063,050) | 83.7% |
| | Shpenzime Operative | 3,276,537 | 3,183,915 | ↑ (92,622) | 97.2% |
| | Provizione | 1,272,257 | 647,986 | ↑ (624,271) | 50.9% |
| | EBITDA | 1,826,585 | 1,006,399 | ↓ (820,186) | 55.1% |
| | Amortizimi | 183,097 | 183,097 | ↓ - | 100.0% |
| | Shpenzime Financiare | 234,790 | 673,332 | ↓ 438,543 | 286.8% |
| | Tatim Fitimi | 379,368 | 124,775 | ↑ (254,593) | 32.9% |
| | Gjithsej | 64,002,655 | 59,951,469 | ↑ (4,051,186) | 93.7% |
| REZULTATI I AKTIVITETEIT | | 1,029,331 | 25,195 | ↓ (1,004,136) | 2.4% |
| Energji e Shitur (Mwh) | | 5,491,194 | 5,343,170 | ↓ (148,024) | 97.3% |
| Arkëtim | | 98.00% | 99.00% | | |

Burimi. FSHU sh.a.

FSHU sh.a. mbështetur në treguesit e sipërpërmendur, ka propozuar që çmimet e shitjes me pakicë të energjisë për periudhën 1 Shkurt 2025 – 31 Dhjetor 2025, për konsumatorët që furnizohen në kushtet furnizimit universal të jenë si më poshtë:

- Për konsumatorët familjarë që konsumojnë më pak se 700 kWh në muaj – 8.5 Lekë/kWh.
- Për konsumatorët familjarë që konsumojnë më shumë se 700 kwh në muaj – 9.5 Lekë/kWh për të gjithë sasinë e konsumuar duke filluar nga kwh i parë
- Çmimet për konsumatorët privatë mbeten të pandryshuara.

Për të qartësuar propozimin e saj FSHU sh.a. ka evidentuar një shembull konkret mbi efektet e aplikimit të çmimeve sa më sipër bazuar në konsumin respektiv si vijon:

- Nëse një konsumator Familjar konsumon deri ne 700 kwh, faturimi do të jetë
8.5 Lekë/kwh* 700 kwh = 5,950 Lekë.
- Nëse një konsumator Familjar konsumon 701 kwh, faturimi do të jetë
9.5 Lekë/kwh * 701 kwh = 6,659.5 Lekë.

FSHU sh.a. deklaron se nga analiza paraprake e treguesve të kostove të pritshme të aktivitetit të shërbimit universal, çmimi mesatar i energjisë për vitin 2025 rezulton në vlerën 10.23 Lekë/kWh.

Për efekt të kontrollit të të dhënave, u krye rillogaritja e kostove të pritshme të paraqitura nga FSHU sh.a. për vitin 2025, nga e cila u konstatua një gabim material në lidhje me çmimin mesatar

të energjisë për klientët që furnizohen në kushtet e shërbimit universal, i cili nga 10.23 Lekë/kWh rezultoi 10.24 Lekë/kWh.

Konform përcaktimeve të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë tek klientët fundorë që furnizohen nga furnizuesi i shërbimit universal (FSHU)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 189, datë 23.11.2017, ERE kreu vlerësimet e saj mbi të ardhurat dhe shpenzimet e shoqërisë duke u bazuar në të dhënat e përcjella në kërkesën sipërcituar, si dhe në raportimet periodike të dërguara deri më tani mbi realizimin e treguesve tekniko ekonomik paraprak, meqënëse shoqëria deri më tani ende nuk ka mbyllur procesin e auditimit të pasqyrave financiare të periudhave të mëparshme ushtrimore, sikurse deklaruar prej saj në korespondencat e deritanishme.

Vlerësimet e ERE në lidhje me kërkesën e shoqërisë FSHU sh.a. për rivlerësim të kostove që përcaktojnë Cmimin me Pakicë për Klientët e Shërbimit Universal nga 1 Shkurt 2025.

| Zeri | | Realizimi sipas të dhënave Paraprake të FSHU 2024 | Vlersimet e ERE per 2025 |
|------|--|---|--------------------------|
| E | Kosto e Energjise se shitur nga KESH | 12,738 | 11,464 |
| | Disbalanca | 543 | 646 |
| TF | Kosto e transmetimit | 4,164 | 4,164 |
| DUOS | Tarifa e Shperndarjes | 31,454 | 31,454 |
| OM | Shpenzime Operative | 3,243 | 3,170 |
| DA | Amortizimi | 183 | 167 |
| RM | Marzhi | 280 | 252 |
| WCA | Kosto e lejuar e kapitalit te punes | 129 | 126 |
| BD | Kompensimi i Borxhit i Keq | 1,055 | 2,572 |
| AXH | Korrigjim i te Ardhurave | (3,481) | (3,839) |
| | Totali i te Ardhurave te Kerkuara | 50,308 | 50,176 |
| | Energji e shitur MWH | 4,899 | 4,899 |
| | Çmimi mesatar i shitjes Lekë/kWh | 10.27 | 10.24 |

Burimi. ERE

Pas shqyrtimit të të dhënave, argumenteve dhe deklarimeve të FSHU sh.a. mbi të cilat është mbështetur propozimi për rilloaritjen e çmimit mesatar të shitjes së energjisë elektrike për klientët që shërbehen në kushtet e shërbimit universal të furnizimit, si dhe mbështetur në përcaktimet e Metodologjisë respektive, paraqesim në vijim vlerësimet dhe arsyetimet tona për secilin komponent të të ardhurave të kërkuara:

1. Kostoja për energjinë elektrike dhe kosto e disbalancave

Në këtë zë përfshihen kostot lidhur me blerjen e energjinë elektrike për qëllime të mbulimit të nevojës për furnizim klientëve që shërbehen në kushtet e shërbimit universal. Mbështetur në pikën 2, të nenit 5, të VKM nr. 456, datë 29.06.2022, “... Shoqëria publike e prodhimit, e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, furnizon Furnizuesin e Shërbimit Universal me të gjithë sasinë e

nevojshme, për furnizimin e klientëve universalë, sipas çmimit për njësi të energjisë elektrike, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë”.

Sa më sipër, FSHU sh.a. nëpërmjet kërkesës së saj ka përcjellë shkresën me nr. 7349, datë 31.12.2024 të përcjellë prej KESH sh.a., në të cilën është bërë me dije se, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarit me anë të vendimit nr. 10121/1, datë 31.12.2024, ka miratuar programin Ekonomik Financiar për vitin 2025 si dhe parashikimin për vitet 2026 – 2029, duke përcaktuar furnizimin me të gjithë sasinë e nevojshme të klientëve universal në nivelin e tensionit 0.4 kV kundrejt tarifës 2.34 Lekë/kWh.

Lidhur me sasinë që pritet të furnizohet për periudhën 2025, është konsideruar parashikimi i kryer nga shoqëria, për të cilën FSHU sh.a. sqaron:

“Plani për rritjen prej 0.7% të sasisë së energjisë së shitur, për klientët që do të mbeten të FSHU SH.A., bazuar në faktin se 2024 ishte një vit i nxehtë, mbetet pak konservativ duke patur parasysh rritjen ekonomike të vendit dhe rritja më e lartë e konsumit do të rriste rrjedhimisht edhe performancën financiare të shoqërisë...Sasia e energjisë që parashikohet të shitet në tensionin 0.4 kv është e njëjtë me sasinë e pritshme të vitit 2024 e cila u ndikua nga moti tejet i nxehtë i verës së këtij viti. Ndërsa sasia e energjisë që do të shitet në tensionin e mesëm është planifikuar të rritet 2% ndikuar nga rritja vjetore ekonomike e vendit. Plani i konsumit të energjisë për vitin 2025 është rreth 0.7% më i lartë se konsumi i pritshëm 2024”.

Sa më sipër, kosto e blerjes së energjisë është përlllogaritur duke konsideruar çmimin e shitjes së energjisë elektrike të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarit të KESH sh.a. prej **2.34 lekë/kWh** kundrejt sasisë së energjisë elektrike të parashikuar për t’u furnizuar prej FSHU sh.a. prej **4,899 GWh**, meqenëse në zbatim të dispozitave të VKM së sipërcituar, kjo sasi do të mbulohet tërësisht prej KESH sh.a.

Në lidhje me kostot e disbalancave, vlera e konsideruar është ajo e paraqitur prej FSHU sh.a. mbështetur në të dhënat paraprake të vitit 2024, mbi të cilat është parashikuar dhe vlera e pritshme e saj për vitin 2025.

2. Kostot e transmetimit dhe kostot e shpërndarjes

Në lidhje me përlllogaritjen e kostos së transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike janë marrë në konsideratë tarifatat e miratuara me vendimet respektive të bordit të ERE të cilat janë të aplikueshme për vitin 2025, si më poshtë:

- Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike, e miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 279, datë 16.12.2024 prej **0.85 lekë/ kWh**.
- Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike, e miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.04.2022, e lënë në fuqi me vendimin e bordit të ERE-s nr. 288, datë 23.12.2024, prej **6.42 lekë/ kWh**.

3. Kostot e mirëmbajtjes dhe të operimit

Në lidhje me kostot operative të parashikuara për tu realizuar për vitin 2025, shoqëria sqaron se peshën kryesore të tyre e zënë “shpenzimet e peronelit”, “shërbimet postare” dhe “shërbimet e ruajtjes”. Në vlerësimin tonë kemi konsideruar koston operative të parashikuar nga FSHU sh.a. për vitin 2025 pasi janë zbritur kostot e parashikuara nga penalitetet dhe gjobat, të cilat sikurse

vërehet në tabelën e mësipërme janë të përafërta me ato të realizuara sipas të dhënave paraprake të vitit 2024. Pavarësisht kësaj, në momentin që shoqëria do të përfundojë procesin e auditimit të Pasqyrave Financiare dhe do t'i depozitojë këto raporte në ERE, kostot operative do të rivlerësohen mbështetur në realizimin e tyre faktik, sipas zërave analitike të secilit grup shpenzimi.

4. Amortizimi

Në lidhje me koston e Amortizimit për vitin 2025, është konsideruar kosto e parashikuar prej FSHU sh.a. si dhe vlerat e realizuara sipas të dhënave paraprake, të vëna në dispozicion nga shoqëria për periudhat e mbyllura ushtrimore.

5. Kosto e financimit të kapitalit të punës

Bazuar në përcaktimet e *“Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë tek klientët fundorë që furnizohen nga furnizuesi i shërbimit universal (FSHU)”*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 189, datë 23.11.2017, kostoja e financimit të kapitali të punës përllogaritet sa një e dymbëdhjeta e vlerës së koston së energjisë elektrike dhe kapacitetit, koston së shërbimit të transmetimit dhe të shpërndarjes dhe kostove të operimit dhe të mirëmbajtjes. Vlera rezultuese paraqitet në tabelën e mësipërme.

6. Marzhi i fitimit

Marzhi i fitimit është përllogaritur mbështetur në normën e njohur deri më tani prej 2,2% të koston së blerjes së energjisë për qëllime të mbulimit të kërkesës së FSHU sipas koston së parashikuar të blerjes së energjisë prej KESH sh.a. ndaj çmimit të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë prej 2.34 lekë/kWh.

7. Borxhi i keq

Përcaktimi i këtij komponenti është marrë në konsideratë mbështetur në normën e riskut të arkëtimit të njohur sipas VKM nr. 253, datë 24.04.2019 *“Për miratimin e Planit të Konsolidimit financiar të Sektorit Publik Elektroenergjitik”*, të ndryshuar me VKM nr. 758, datë 09.12.2021 në normën 5% ndaj të ardhurave të kërkuara të vlersuara për vitin 2025.

8. Korrigjimi i të ardhurave

Korrigjimi i vlerësuar nga ERE është përllogaritur duke u bazuar në treguesit ekonomik paraprak (për arsye se shoqëria vijon të mos ketë përfunduar procesin e auditimit të pasqyrave financiare të periudhave të mëparshme ushtrimore 2022 - 2023), si dhe në sasitë faktike të furnizuara prej FSHU sh.a., në kushtet e shërbimit universal të furnizimit të periudhave paraardhëse, të përcjella përmes raporteve periodike. Ndërkohë që për vitin 2024 janë marrë në konsideratë të dhënat paraprake ekonomike si dhe sasia e parashikuar për t'u furnizuar prej FSHU sh.a. të vëna në dispozicion në korrespondencën e sipëctuar. Korrigjimi i të ardhurave ka konsideruar diferencat ndërmjet kostove të parashikuara për njësi dhe atyre të realizuara nga aktiviteti ushtrimor përfshirë këtu shpenzimet operative, amortizimi, disbalancat; diferencat e të ardhurave të realizuara nga struktura e shitjes për secilën kategori klientësh; koston faktike të blerjes së energjisë, transmetimit dhe shpërndarjes për qëllime të mbulimit të kërkesës për energji si dhe të ardhurat e realizuara mbi/nën kërkesën e lejuar për të ardhura.

Të ardhurat e kërkuara për vitin 2025

| Përshkrimi | Përlllogaritjet e FSHU për 2025 | Vlersimet e ERE per 2025 |
|--|---------------------------------|--------------------------|
| Totali i te Ardhurave te Kerkuara | 50,163 | 50,176 |
| Energji e shitur MWH | 4,899 | 4,899 |
| Çmimi mesatar i shitjes Lekë/kWh | 10.24 | 10.24 |

Burimi. ERE

Në përfundim të vlerësimeve të kryera më sipër, mbështetur në përlllogaritjet e bazuara mbi dispozitat e “*Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë tek klientët fundorë që furnizohen nga furnizuesi i shërbimit universal (FSHU)*”, mitatuar me vendimin e bordit të ERE nr. 189, datë 23.11.2017, sikurse pasqyruar dhe në tabelën e mësipërme, të ardhurat e kërkuara nga shoqëria për vitin 2025 rezultojnë në vlerën 50,163 milion lekë të cilat janë pothuajse në të njëjtin nivel me ato të vlerësuara nga ERE prej 50,176 milion lekë, mbështetur në arsyetimet dhe vlerësimet mësipërme lidhur me kostot e aktivitetit të FSHU sh.a.. Çmimi mesatar i shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët fundorë që furnizohen nga FSHU sh.a. për vitin 2025 rezulton në vlerën 10.24 lekë/kWh, sikurse dhe çmimi i propozuar prej FSHU sh.a. në kërkesën e sipërcituar.

Mbështetur në dispozitat e Metodologjisë përkatëse, për të vlerësuar nëse çmimet e propozuara prej FSHU sh.a. mundësojnë të ardhurat e nevojshme për të mbuluar aktivitetin e saj ushtrimor për vitin 2025, u krye dhe vlerësimi i të ardhurave të pritshme prej strukturës së shitjes, e cila pritet të aplikohet për periudhën 1 shkurt – 31 dhjetor 2025.

Shoqëria deklaron se, nga analiza e sjelljes konsumatore, mbështetur në të dhëna historike vërehet se rreth 78% e klientëve familjarë kanë një konsum mujor me të ulët se 700 kwh dhe rreth 22% e tyre konsumojnë më shumë se 700 kwh në muaj. FSHU sh.a. ka llogaritur për vitin 2025 se, nëse çmimi i energjisë për klientët familjarë që konsumojnë më pak se 700 kWh në muaj do të jetë 8.5 Lekë/kWh dhe çmimi për konsumatorët familjarë që konsumojnë më shumë se 700 kwh në muaj do të jetë 9.5 Lekë/kwh, ndërkohë që çmimet për klientët privatë që furnizohen në kushtet e shërbimit universal mbeten të pandryshuara. Çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike nga FSHU sh.a. për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 0.4 kV do të jetë ai i përlllogaritur sa më sipër në kërkesën e saj, prej 10.24 lekë/kWh.

Nisur nga këto deklarime, pas kryerjes së përlllogaritjeve përkatëse të të ardhurave që priten të realizohen prej çmimeve të propozuara nga FSHU sh.a. kundrejt sasive respektive sipas analizës së mësipërme, ku për secilën kategori klientësh është vlerësuar sasia e pritshme për t’u konsumuar sipas peshës së konsumit bazuar në strukturën e shitjes 11 mujore të vitit 2024, rezulton se çmimet e propozuara për t’u aplikuar për periudhën 1 shkurt – 31 dhjetor 2025 mbulojnë kostot e parashikuara/të ardhurat e kërkuara të pritshme për vitin 2025.

Në përfundim të vlerësimeve të mësipërme, theksojmë se shoqëria FSHU sh.a. sapo të përfundojë procesin e auditimit të Pasqyrave Financiare të periudhave të mbyllura ushtrimore, duhet të paraqesë në ERE Aplikimin për përcaktimin e çmimit të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, mbështetur në përcaktimet e Rregullores për “*Organizimin, Funksionimin dhe procedurat e ERE-s*”, miratuar me Vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016 të bordit të ERE-s, “*Sistemit të njehsuar dhe të standardizuar të*

llogarive për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike për aktivitetin e shpërndarjes dhe furnizuesit të shërbimit universal të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 244, datë 26.11.2018, si dhe “Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë tek klientët fundorë që furnizohen nga furnizuesi i shërbimit universal (FSHU)”, mitatuar me vendimin e bordit të ERE nr. 189, datë 23.11.2017.

Duke qenë se, të dhënat mbi të cilat është kryer ky vlerësim janë paraprake, në rast të konstatimit të ndryshimeve të komponentëve përlllogaritës, ERE mbështetur në “Metodologjinë e përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë tek klientët fundorë që furnizohen nga furnizuesi i shërbimit universal (FSHU)” do të kryej korrigjimet përkatëse.

Përsa më sipër shpjeguar si dhe në mbështetje të neneve 16; 19; 20, gërma “c”; 83 dhe 85 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; VKM-s nr. 456 datë 29.06.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “c” të ‘Rregullores për Organizimin, Funkionimin dhe Procedurat e ERE-s’, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; “Metodologjisë së Përcaktimit të Çmimeve për Shitjen e Energjisë Elektrike me Pakicë tek Klientët Fundorë që Furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 189, datë 23.11.2017, i propozojmë bordit të ERE-s:

1. Miratimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike për periudhën 1 Shkurt 2025 – 31 Dhjetor 2025 sipas tabelës bashkëlidhur.

| ÇMIMET E SHITJES ME PAKICË TË ENERGISË ELEKTRIKE PËR KLIENËTË FUNDORË QË SHËRBEHEN NGA FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL PËR PERIU DHËN 1 SHKURT- 31 DHJETOR 2025 | | |
|--|-------------------------------------|---|
| Përshkrimi | Çmimi i energjisë aktive (Lekë/kWh) | **Çmimi i energjisë aktive në orar pik (Lekë/kWh) |
| Klientë të lidhur në 0.4 kV | 14 Lekë/ kWh | 16.1 Lekë/ kWh |
| Furra buke dhe prodhim mielli në 0.4 kV: | | |
| <i>Kategoria I - Furra buke/ Prodhim mielli në 0.4 kV</i> | 7.6 Lekë/ kWh | 8.74 Lekë/kWh |
| <i>Kategoria II - Furrë buke, produkte mielli shoqëruese dhe pastičeri në 0.4 kV</i> | 9.5 Lekë/kWh | 10.93 Lekë/kWh |
| <i>Kategoria III - Furrë buke, produkte mielli shoqëruese dhe pastičeri, shërbim kafe në 0.4 kV</i> | 12 Lekë/kWh | 13.80 Lekë/kWh |
| Objekte kulti dhe bashkësi fetare | 9.5 Lekë/kWh | |
| Familjarë: | | |
| <i>Konsumatorët familjarë që konsumojnë më pak se 700 kwh në muaj</i> | 8.5 Lekë/kWh | |
| <i>Konsumatorët familjarë që konsumojnë më shumë se 700 kwh në muaj</i> | * 9.5 Lekë/kWh | |
| Çmimi për konsumin e energjisë elektrike në ambientet e përbashkëta (Ndriçim shkalle, pompë, ashensor,) | 9.5 Lekë/kWh | |
| * Për konsumatorët familjarë të cilët konsumojnë 701 kWh në muaj e më tej, çmimi i energjisë elektrike do të jetë 9.5 lekë/kWh për të gjithë sasinë e konsumuar gjatë një muaji | | |
| **Orari pik gjatë të cilit do të aplikohet çmimi për energjinë e konsumuar në pik është: | | |
| Për periudhën 1 Nëntor - 31 Mars nga ora 18:00 - 22:00 | | |
| Për periudhën 1 Prill - 31 Tetor nga ora 19:00 - 23:00 | | |

2. Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e realizuara mbi/nën kërkesën e lejuar, do të bëhet korrigjimi dhe kompensimi përkatës i tyre, në përputhje me përcaktimet e nenit 20, gërma “c” të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar dhe metodologjive përkatëse, të miratuara nga ERE.